



## ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

### REAGIM PUBLIK

OMK me shqetësim të madh është vënë në dijeni për deklarimet e Hetem Ramadani të emisionin Rubikon të kanalit televiziv Klan Kosova, lidhur me temën e vaksinimit, në të cilën ai deklaron se "Mjekët janë një ndër vrasësit më të mëdhenjë në botë për shkak të gabimeve, për shkak të mosdijes, për shkak të interesave që janë agjentë të farmacisë".

OMK, deklarimet e tillë për vrasje i konsideron se janë akuza të rënda ndaj mjekëve si profesionistë shëndetësor, e që kanë për qëllim stigmatizimin dhe shënjestrimin e figurës së mjekut në shoqëri. Me qëllim të ruajtjes së dinjitetit dhe ndërgjegjjes së mjekut, kjo gjuhë e ashpër duhet dënuar nga shoqëria dhe si e tillë të konsiderohet e papranueshme.

Oda e Mjekëve përmes këtij reagimi dënon ashpër një deklaratë të tillë e cila paraqet akuzë të drejtpërdrejt ndaj komunitetit mjekësor, për veprime që përbëjnë krimë të rënda siç është privimi i njerëzve ngajeta. Pasoja esenciale e deklarimeve të tillë është paragjykimi ndaj profilit të mjekut, duke ndikuar në raportin në mes të mjekut dhe pacientit, përmes cënimit të besueshmërisë së prezumuar.

Gjithashtu duke qenë të vetëdijshëm se kohëve të fundit jemi përballur me pandeminë Covid-19 dhe kontributin e mëdh të mjekëve në parandalimin e përhapjes të këtij virusi si dhe mbrojtjen e jetës njerëzore, OMK nuk do të lejojë që të cenohet dinjiteti dhe integriteti profesional i mjekut, i cili si profesionist shëndetësor kujdeset për jetët e qytetarëve duke rrezikuar e jetërat e tyre në angazhimin e luftimit të situatave të tillë të cilat rëndojnë shëndetin e qytetarëve të vendit tonë.

Pohimet e tillë përbëjnë elemente të vepërës penale të nxitjes së urrejtjes, e sankzionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Ne konsiderojmë se organet ligjzbatusë duhet të ndërmarrin veprime konkrete për të parandaluar çfarëdo paragjykimi dhe shkaktim të pasojave të kundërligjshme, përfshirë ato që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit.

Krejt në fund, është për keqardhje krijimi i hapësirës dhe mundësisë nga mediat për sharllatanët e tillë si Hetem Ramadani, dhe jo vetëm ai.

PRISHTINË, 19 qershori 2020

Oda e Mjekëve të Kosovës

